



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Raporti narrativ gjashtë-mujor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme ka të miratuara 11 akte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021. Nga 11 akte të miratuara, vetëm një prej tyre është i kualifikuar për konsultime publike. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023 (PKIE 2021-2023). Akti ka si objekt miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023 të përgatitur nga grupet ndërinstitucionale të punës për secilin kapitull të *acquis* si dhe ministritë përgjegjëse për secilin kapitull të negociatave të pranimit në BE. Nisur nga praktika e viteve të kaluara Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka patur si aktivitet kryesor për pjesën e konsultimit publik organizimin e takimeve publike, të hapur për çdo person të interesuar (individ, ekspert apo organizatë) në procesin e konsultimit publik të PKIE-së. Metoda e njoftimit për organizimin e takimit publik kryhej nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) si dhe gjithashtu MEPJ ka njoftuar me postë elektronike të gjitha kontaktet e shoqërisë civile, ekspertëve që disponon për datën e konsultimit publik duke e konsideruar dhe si një ftesë për pjesëmarrje. Në kushtet e një situatë pandemie të shkaktuar nga virusi Covid-19 si dhe në kuadër të masave shtrënguese të marra për parandalimin e tij, këtë vit konsultimi publik i PKIE 2021-2023 u krye vetëm nëpërmjet regjistrimit elektronik të konsultimit publik. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është një dokument strategjik voluminoz dhe për këtë arsye gjatë takimeve publike të konsultimit Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka prezantuar një përmbledhje mbi çështjet më kryesore që trajton Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Në këtë kuadër përfaqësuesit e grupeve të interesit apo individët e interesuar pjesëmarrës në takim, kanë patur mundësinë e një prezantimi të dokumentit strategjik që ka derivuar në diskutime të ndërsjellta

mbi projektaktin duke krijuar mundësinë e dhënies të komenteve apo sugjerimeve të ndryshme nga pjesëmarrësit mbi aktin.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka miratuar gjithsej 11 akte në Këshill të Ministrave për periudhën janar-qershor 2021.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga 11 akte të miratuara për periudhën, objekt i ligjit nr. 146/2014 për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është vetëm projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023”, i cili i është nënshtruar procesit të konsultimit publik.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nuk është e aplikueshme për ligjet e planifikuara për miratim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga 11 aktet e miratuara për periudhën, 10 prej tyre nuk i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Të gjitha aktet e pa konsultuara, janë akte që kanë si objekt miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Referuar parashikimeve të nenit 4 pika b të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, aktet që miratohen në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.90, datë 17.2.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2021–2023.”

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme në vitet e kaluara ka njoftuar konsultimin e aktit përmes një takimi publik dhe u dërgonte ftesa personave të interesuar për të marrë pjesë në takimin publik për konsultimin e PKIE. Sikurse është përmendur dhe më lart, për vitin 2021 për arsye të masave shtrënguese për covid19, e vetmja metodë për konsultimin publik të PKIE 2021-2023 ishte nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike. Nëpërmjet konsultimit me këtë metodë nuk u gjeneruan komente mbi aktin.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metoda e përdorur për konsultimin publik të PKIE 2021-2023 ishte vetëm nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike. Shpallja e aktit për konsultim publik qëndroi e publikuar në këtë faqe 20 ditë pune sipas parashikimeve ligjore.

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda e vetme e përdorur për konsultimin publik të PKIE 2021-2023 ishte nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike. Nga konsultimi nëpërmjet regjistrit elektronik nuk pati komente për aktin edhe pse faqja në këtë regjistër ku ishte publikuar akti ishte klikuar nga një numër i konsiderueshëm personash.

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Nuk janë organizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Për 20 ditë pune sikurse kërkuar nga ligji ka qenë planifikuar vetëm një proces konsultimi nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike. Masat shtrënguese në kuadër të situatës të krijuar nga covid19, nuk mundësonin organizimin e takimeve publike për konsultimin e aktit.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Konsultimi publik i Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në regjistrin elektronik të konsultimeve publike.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në vitet e kaluara procesi i konsultimit publik të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian është kryer përmes takimeve publike të mbajtura pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Këtë vit procesi i konsultimit publik të PKIE-së është kryer nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimit publik në përputhje me nenin 7 të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Nuk ka patur palë interesi të jashtme në grupet e punës brenda MEPJ-së për hartimin e PKIE 2021-2023. PKIE është e ndarë në kapitullin “Kriteri Politik” dhe “Kriteri ekonomik” si dhe pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues. Procesi i planifikimit të PKIE-së kryhet nga institucionet përgjegjëse/lider të kapitujve. Gjatë gjithë procesit të planifikimit MEPJ koordinon punën me GNPIE-të e të 33 kapitujve për hartimin e PKIE-së.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Referojuni pikës 2.4.1.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë konsultimit nëpërmjet regjistrit publik të konsultimeve nuk u gjenerua asnjë koment.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Referojuni pikës 2.4.3.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Sikurse është përmendur dhe më lart përfaqësuesit e grupeve të interesit apo individët e interesuar pjesëmarrës në takim publik, kanë patur mundësinë e një prezantimi të dokumentit strategjik që ka derivuar në diskutime të ndërsjellta mbi projektaktin duke krijuar mundësinë e dhënies të komenteve apo sugjerimeve të ndryshme nga pjesëmarrësit mbi projektaktin.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Gjatë procesit të konsultimit publik të PKIE 2021-2023 nuk ka patur komente.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Referojuni pikës 2.5.1.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Tendenca në dhënien e mendimeve krahasuar me vitin e kaluar është në rënie. Në vlerësim të procesit të konsultimit dhe vetë aktit të konsultuar vërehet se Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është një dokument strategjik në të cilin përfshihen fusha të ndryshme dhe informacioni që përcillet është voluminoz. Për këtë arsye takimet publike kanë gjeneruar më shumë komente të karakterit të përgjithshëm për fushat që trajton akti , për arsye të komunikimit të ndërsjellë midis përfaqësuesve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raporti VNR nuk është aplikuar për aktin e konsultuar.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për procesin e konsultimit publik të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023 është përgatitur raport individual mbi konsultimin publik të aktit dhe është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk ka patur raporte të pa publikuara.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për gjashtë mujorin e parë për vitin 2021 sikurse është cituar dhe më lart ka konsultuar gjithsej një akt. Nisur nga kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, sugjerojmë vlerësimin maksimal 8 për procesin e kryer të konsultimit publik për aktin.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Për të rritur cilësinë dhe transparencën në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore, është e nevojshme të ngrihen kapacitetet e ministrisë për administrimin e konsultimeve publike. Gjithashtu duhet të konsiderohet dhe ristrukturimi organizativ për një shpërndarje më të mirë të personelit dhe përshtetshëm pune të qartë. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është një dokument i rëndësishëm strategjik dhe trajton një informacion të gjerë dhe voluminoz. Vlen të përmendet se kontributi mbi përditësimin e PKIE përcillet nga grupet ndërinstitucionale të punës dhe institucionet lider të kapitujve. Për këtë arsye do ishte në favor të procesit që konsultimi publik i aktit të kryhej për secilën fushë që prek dokumenti strategjik nga vetë institucionet lider të kapitujve që propozojnë ndryshimet në akt.

